FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 106	2003	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4036 datë 22.12.2003	Për falje dënimi……	4541
Vendim i KM nr.824, datë 11.12.2003	Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme……	4543
Vendim i GJK nr.36, datë 19.12.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1958, datë 25.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1252, datë 1.11.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1384, datë 27.12.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë……	4579
Vendim i GJK nr.37, datë 22.12.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.760, datë 27.2.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.672, datë 5.6.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.854, datë 8.5.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë……	4581
Vendim i GJK nr.38, datë 23.12.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.3, datë 30.1.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë……	4584

Vendim i GJK nr.39, datë 23.12.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.14, datë 5.4.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.126, datë 20.1.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese……	4586
Udhëzim i KQZ nr. 20, datë 22. 12. 2003	Për një shtesë në udhëzimin nr.9, datë 20.9.2003 "Mbi procedurën e numërimit të votave dhe administrimin e fletëve të votimit nga komisioni i qendrës së votimit", ndryshuar me udhëzimin nr.18, datë 11.10.2003…….	4589
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Faik Tafa.……	4589

DEKRET
Nr.4036, datë 22.12.2003

PËR FALJE DËNIMI

Në mbështetje të neneve 92 pika b dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë dhe organeve të pushtetit lokal, me rastin e festave të fundvitit,

DEKRETOJ:

Neni 1

1. Sose Andre Puci, dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjirokastër, me vendimin nr.49, datë 21.6.1996, i falet dënimi i mbetur.

2. Farie Fejzullah Açka, dënuar nga Gjykata e Rrethit Bulqizë, me vendimin nr.41, datë 14.10.1999, i falet dënimi i mbetur.

3. Manushaqe Feim Çaushi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Devoll, me vendimin nr.31, datë 3.10.1994, i falet dënimi i mbetur.

4. Bardha Sadik Vladi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.314, datë 24.5.1999, i falet dënimi i mbetur.

5. Resmije Bajram Kiptiu, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.46, datë 31.1.2003, i falet dënimi i mbetur.

6. Sofie Zeqir Lleshi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mat, me vendimin nr.36, datë 13.7.1999, i falet dënimi i mbetur.

7. Suela Namik Tabaku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Elbasan, me vendimin nr.14, datë 20.1.2003, i falet dënimi i mbetur.

8. Ferdinant Koçi Arapaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.21, datë 23.2.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

9. Eduard Enver Avdiaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.21, datë 23.2.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

10. Ndue Gjon Prenga (Lleshi), dënuar nga Gjykata e Rrethit Pukë, me vendimin nr.82, datë 17.11.1999, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

11.Olsi Hasan Mulla, dënuar nga Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr.205, datë 23.11.2001, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

12. Fatmir Hajdar Metalia, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kukës, me vendimin nr.95, datë 9.11.1999, i falet dënimi i mbetur.

13. Gëzim Qerim Seferi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Bulqizë, me vendimin nr.27, datë 30.7.1998, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

14. Fatmir Selim Shehu, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.175, datë 12.9.2001, i falet dënimi i mbetur.

15. Orion Ded Suta, dënuar nga Gjykata e Rrethit Pukë, me vendimin nr.55, datë 3.10.2001, i falen 3 vjet nga dënimi i mbetur.

16. Sabah Selman Pashku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, me vendimin nr.34, datë 9.11.1999, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

17. Artan Qamil Bardhoshi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.712, datë 2.11.2001, i falet dënimi i mbetur.

18. Genci Pëllumb Idrizi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Pogradec, me vendimin nr.48, datë 10.9.2002, i falet dënimi i mbetur.

19. Albano Ylli Lulushi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.98, datë 3.4.2002, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

20. Koço Dine Cacaj (Kristo Nasho), dënuar nga Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr.60, datë 6.10.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

21. Kujtim Zeqir Dervishi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.3, datë 15.11.2001, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

22. Gazmend Nazif Muhaxheri, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.456, datë 30.12.2002, i falet dënimi i mbetur.

23. Qerim Rexhep Skaci, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kukës, me vendimin nr.66, datë 4.5.2001, i falen 3 vjet nga dënimi i mbetur.

24. Luan Qamil Berberi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kavajë, me vendimin nr.12, datë 21.1.1997, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

25. Klodian Besnik Zerollari, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin n.81, datë 12.2.2002, i falet dënimi i mbetur.

26. Sulejman Ilmi Shenbitraku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr.56, datë 28.2.2002, i falet dënimi i mbetur.

27. Avni Latif Elqemi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vedimin nr.234, datë 29.3.2001, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

28. Sefedin Bilbil Shehaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr.17, datë 17.5.1998, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

29. Julian Demir Sula, dënuar nga Gjykata e Rrethit Elbasan, me vendimin nr.112, datë 7.10.1999, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

30. Martin Mark Perduka, dënuar nga Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.161, datë 4.7.2003, i falet dënimi i mbetur.

31. Armand Bari Tafa, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.817, datë 14.11.2002, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

32. Luan Ibrahim Dukaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Krujë, me vendimin nr.34, datë 27.5.2002, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

33. Elvis Hiqmet Muça, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.497, datë 26.6.2001, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

34. Osman Fadil Murrja, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.50, datë 10.7.2001, i falet dënimi i mbeur.

35. Mentor Ali Manuka, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.50, datë 10.7.2001, i falet dënimi i mbetur.

36. Armel Gëzim Balliu, dënuar nga Gjykata e Rrethit Berat, me vendimin nr.64, datë 9.6.1999, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

37. Mexhit Fejzi Matmuja, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kukës, me vendimin nr.167, datë 22.12.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

38. Altin Yzejdin Musaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr.22, datë 7.2.2001, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.824, datë 11.12.2003

PËR KLASIFIKIMIN, AMBALAZHIMIN, ETIKETIMIN DHE RUAJTJEN E

SUBSTANCAVE DHE TË PREPARATEVE TË RREZIKSHME

Në mbështetje të nenit të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9108, datë 17.7.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 Ky vendim ka për qëllim të rregullojë prodhimin, tregtimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, duke respektuar legjislacionin shqiptar dhe rregullat ndërkombëtare.

1.2 Vendimi përcakton parimet e klasifikimit të substancave dhe të preparateve të rrezikshme, në përputhje me klasifikimin ndërkombëtar dhe përshtat udhëzimet e fundit të Komitetit Europian për ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme.

1.3 Vendimi nuk prek detyrimet në transportin e mallrave të rrezikshme, të përcaktuara në urdhëresën nr.1, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e klasifikimit, emërtimin dhe transportit rrugor të mallrave të rrezikshme". Udhëzimi nuk është i zbatueshëm për kimikatet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sepse këto trajtohen me rregullore të veçantë për substancat radioaktive, produktet që përmbajnë lëndë radioaktive ose asbeste, produktet mjekësore, ushqimet, preparatet kozmetike, lëndët e para minerare, eksplozivët, preparatet për mbrojtjen e bimëve, substancat narkotike, psikotropike, si dhe për substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit.

1.4 Vendimi dhe aktet në zbatim të tij janë të detyrueshme për të gjithë personat juridikë dhe fizikë që merren me prodhimin, tregtimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme.

2. Përkufizimi i simboleve dhe i termave

2.1. Simbolet e rrezikshmërisë

Simbo1i E shenjë e pranuar për lëndët plasëse, shpërthyese e eksplozive.

O shenjë e pranuar për lëndët djegëse, oksiduesit e lëndës së djegshme.

Simboli F shenjë e pranuar për lëndët lehtësisht të ndezshme.

F+ shenjë e pranuar për lëndët ekstremisht të djegshme (eksploziv).

Simbo1i T shenjë e pranuar për lëndët toksike (helmuese).

T+shenjë e pranuar për lëndët shumë toksike (shumë helmuese).

Simbo1i C shenjë e pranuar për lëndët korrozive.

Xn shenjë e pranuar për lëndët e dëmshme.

Simboli Xi shenjë e pranuar për lëndët irrituese.

N shenjë e pranuar për lëndët e rrezikshme për mjedisin.

2.2 Natyra e rrezikut e përcaktuar në aneksin nr.l, që bashkëlidhet këtij vendimi

Simboli R shenjë e pranuar për natyrën e rrezikut.

2.3 Simboli i kujdesit i përcaktuar në aneksin nr.2, që bashkëlidhet këtij vendimi

Simboli S shenjë e pranuar për rregullin e sigurisë.

2.4 LD 50 - doza e marrë në mënyrë orale ose e intenvenuar, e cila është vdekjeprurëse (letale) në 50 për qind, të kafshëve të testuara.

2.5 LC 50 - koncentrimi në ajër ose në ujë, i cili është vdekjeprurës (letal) në 50 për qind, të kafshëve të testuara.

2.6 CAS No-(Chemical Abstracts Service number) është kodi ndërkombëtar, me të cilin substanca identifikohet.

2.7 ELINCS-(European list of notified chemical substances) është lista europiane e substancave kimike.

2.8 EINECS-(European Inventory of Existing Comercial Chemicals Substances) Inventari Europian i Substancave Kimike Tregtare Ekzistuese. Numuri EINECS, i përcaktuar për substancën, paraqitet në një listë që përfshin informacionin për substancën në përdorim tregtar në territorin e KE-së.

2.9 HAZCHEM-(Hazardous Chemicals)-Kimikate të rrezikshme.Ky kod jep informacion të

hollësishëm se si duhet të veprohet në rastet e ekspozimit, zjarrit, aksidentit.

2.10 KEMLER-Number është numër që informon llojin dhe nivelin e rrezikut që sjell kimikati.

2.11 ADR/RID-(International Regulation for transport of dengerous chemicals by road or by rail) Rregullat ndërkombëtare për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë (ADR) dhe hekurudhë (RID).

2.12 UN-Number është numër, i cili bën të mundur përcaktimin e substancës kimike (mallit) gjatë transportit me kontenier.

2.13 F.A-(First Aid) është numur i buletinit, i cili përmban informacione për ndihmën e parë, që duhet të jepet në rastet e ekspozimit ndaj substancës së rrezikshme.

2.14 S.A- (Spillage)derdhje është numër i buletinit, i cili tregon rrugët që duhet të ndiqen në rast se ndodh derdhje e substancës së rrezikshme.

2.15 IATA/ICAO-(International Air Transport Association/-(International Civil Aviation Organization) janë organizzata që japin të dhëna lidhur me transportin ajror ndërkombëtar të kimikateve të rrezikshme.

2.16 IMDG-(International Marittime Kod for Dengerours Goods) Kodi ndërkombëtar detar për mallra të rrezikshme.

3. Klasifikimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme

Klasifikimin i substancave dhe preparateve të rrezikshme bëhet sipas Sistemit ndërkombëtar, i cili bazohet në vetitë fiziko-kimike, toksikologjike, efektet specifike në shëndetin e njeriut, efektet në ndotjen e mjedisit.

3.1- Klasifikimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme sipas vetive fiziko-kimike

3.1.1 Eksplozive janë lëndët që mund të veprojnë në mënyrë ekzotermike, pa praninë e oksigjenit me zhvillim të shpejtë gazesh ose që vetëndizen dhe digjen shpejt në kushte të caktuara ose që shpërthejnë me ngrohje kur vendosen në kontenierë johermetikë (pjesërisht të mbyllur).

3.1.2 Oksiduese janë lëndët që në kontakt me substanca të tjera, në veçanti substanca të ndezshme, shkaktojnë reaksion ekzotermik të fuqishëm.

3.1.3 Ekstremisht të ndezshme janë lëndët që, në gjendje të lëngët, kanë pikë flakërimi më të ulët se 0°C dhe pikë vlimi më të ulët se 35 °C ose që janë të ndezshme në gjendje të gaztë në kontakt me ajrin në temperaturë (të dhomës) dhe presion (atmosferik) normal.

3.1.4 Shumë të ndezshme janë lëndët që:

a) mund të nxehen në mënyrë spontane dhe pastaj të digjen në kontakt me ajrin në temperaturë normale (të dhomës), presion normal (atmosferik) dhe pa prani të energjisë;

b) mund të digjen lehtësisht në gjendje të ngurtë, si pasojë e një kontakti të shkurtër me një burim zjarri (ndezje) dhe vazhdojnë të digjen ose tymosin edhe pas largimit të burimit të zjarrit.

c) kanë një pikë ndezje në gjendje të lëngët më të ulët se 21°C dhe nuk janë ekstremisht të ndezshme;

d) në kontakt me ujin ose ajrin e lagët çlirojnë gaze shumë të rrezikshme në sasi të paktën 1 litër/kg.h.

3.1.5 Të ndezshme janë lëndët që kanë pikë flakërimi 21-55 °C.

3.1.6 Shumë helmuese janë lëndët që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë edhe në sasi të vogla mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit ose vdekje.

3.1.7 Helmuese janë lëndët që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë edhe në sasi të vogla mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit ose vdekje.

3.1.8 Të dëmshme për shëndetin janë lëndët që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë edhe në sasi të vogël mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit ose vdekje.

3.1.9 Korrozive janë lëndët që në kontakt me indet e gjalla (jetësore) mund t'i shkatërojnë ato.

3.1.10 Irrituese janë lëndët që nuk kanë vetitë e substancave korrozive, por që, nga kontakti i drejtpërdrejtë për një kohë të gjatë me lëkurën ose membranat mukoze, mund të shkaktojnë inflamacione.

1.11 Sensibilizuese janë lëndët që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë hipersensibilitet dhe për pasojë, pas një ekspozimi tjeter, shfaqen simptomat karakteristike.

1.12 Kancerogjene janë lëndët që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rritin frekuencen e shfaqes së kancerit.

1.13 Mutagjene janë lëndët që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të

shkaktojnë ose të rritin frekuencën e shfaqjes së dëmtimeve gjenetike.

1.14 Toksike për riprodhimin janë lëndët që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rritin frekuencën e dëmtimeve në funksionin e riprodhimit ose në aftësinë riprodhuese të meshkujve ose femrave.

1.15 Të rrezikshme për mjedisin janë lëndët që pas futjes në mjedis përbëjnë ose mund të përbëjnë një rrezik imediat ose të mëvonshëm për mjedisin.

3.2-Klasifikimi në bazë të vetive toksikologjike

A- Kriteret e përgjithshme të klasifikimit të substancave dhe të preparateve të rrezikshme në kategoritë shumë helmuese (shumë toksike), helmuese (toksike), të dëmshme, të përcaktohen në bazë të të dhënave eksperimentale, të realizuara në përputhje me kriteret e mëposhtme, në të cilat merren parasysh (shkalla) madhësia e këtyre efekteve.

3.2.1 Shumë toksike

Substancat dhe preparatet që klasifikohen shumë toksike shënohen me simbolin T+ dhe treguesin e rrezikut "shumë toksik", në përputhje me kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:

R 26 -shumë toksik me frymëmarrje;

R 27 -shumë toksik në kontakt me lëkurën;

R 28 –shumë toksik në rast gëlltitjeje;

R 39 -i rrezikshëm me efekte shumë të rënda, të pakthyeshme.

3.2.2. Toksike

Substancat dhe preparatet klasifikohen si toksike dhe shënohen me simbolin T dhe treguesin e rrezikut "toksik", në përputhje me kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon

R 25- toksik në rast gëlltitje

- rezultatet e toksicitetit akut:

LD 50 (oral) për minj 25 < LD so < 200 mg/kg (peshë)

R 24-toksik në kontakt me lëkurën

- rezultatet e toksicitetit akut:

LD 50 (lëkurë) për minj dhe lepuj 50 < LD 50 < 400 mg/kg

R 23-toksik me frymëmarrje

- rezultati i toksicitetit akut:

LC 50 (me frymëmarrje) për minj 0,25< LC 50 < 1 mg/litër për 4 orë

R 39-I rrezikshëm me efekte shumë të rënda të pakthyeshme

R 48-Mund të provokojë prishje gjenetike të trashëgimisë

3.2.3 - I dëmshëm

Substancat dhe preparatet klasifikohen si të dëmshme dhe shënohen me simbolin Xn dhe treguesin e rrezikut "I dëmshëm", në përputhje me kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:

R 22- I dëmshëm në rast gëlltitjeje

- rezultatet e toksicitetit akut

LD 50 (oral) per minj 200 < LD 50 < 2000 mg/kg (peshë)

R 21- i dëmshëm në kontakt me lëkurën

- rezultatet e toksicitetit akut:

LD 50 (lëkurë) për minj ose lepuj 400 < LD 50 < 2000 mg/kg (peshë)

R 20- i dëmshëm me frymëmarrje

-rezultati i toksicitetit akut:

LC 50 (me frymëmarrje) për minj 1 < LC 50 $\leq$ 5 mg/litër për 4 orë

R 40-Mundëson efekte të pakthyeshme.

R 42-Mund të shkaktojë sensibilizim me frymëmarrje

R 48-Mund të shkaktojë dëmtime gjenetike të trashëgimisë

Të dhënat për efektet e substancave dhe të preparateve shumë toksike, toksike dhe të dëmshme jepen në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr.1.

Tabela nr. 1

Kategoria	LD50 për minj ose lepuj në rrugë orale(goje) mg/kg	LD50 për minj ose lepuj me veprimin në lëkurë mg/kg	LC 50 për minj me anë të frymëmarrjes mg/litër /4orë

	peshë trupore		
Shumë toksik	3/ 4 e 25	3 / 4 e 50	3/ 4 e 0,25
Toksik	25-200	50-400	0,25-1
i dëmshëm	200-2000	400-2000	1-5

B. Klasifikimi i substancave dhe preparateve në kategorinë korroduese dhe irrituese bëhet sipas kritereve të mëposhtme:

3.2.1 Korrozive

Kur substanca ose preparati klasifikohet si korrozive, shënohet me simbolin C dhe tregusin e rrezikut "Korrozive" të përcaktuara me kriteret e mëposhtme:

R 35- Shkakton djegie të rëndë

Në kontakt me lëkurën e kafshës gjatë ekspozimit për 3 minuta ndodh shkatërrimi në thellësi i indeve të lëkurës.

R 34-Shkakton djegie

Në kontakt me lëkurën e kafshës gjatë ekspozimit për 4 orë shkatërron në thellësi indet e lëkurës.

3.2.2 Irrituese

Një substancë ose preparat vlerësohet irritues, në qoftë se shkakton një inflamacion të lëkurës ose dëmtim të syve, në bazë të vlerësimit të parametrave të mëposhtme:

a) Për lëkurën

- Kur inflamacioni i lëkurës, pas një periudhe maksimale ekspozimi prej 4 orësh, qëndron 24 orë, 48 orë ose 72 orë dhe vlera mesatare e formimit të edemës (enjtjes), i llogaritur për të gjitha kafshët që i nënshtrohen provës, është ≥ 2.

b) Për sytë

Dëmtimi i syve konsiderohet kur brenda 72 orëve, pas një ekspozimi të paktën 24 orë, shfaqet dëmtim i njëjtë me ato të eksperimentuar në lepujt e butë. Vlera mesatare e numrit për secilin tip dëmtimi, të llogaritur në të gjitha kafshët që i nënshtrohen provës, do të jetë:

- opaciteti i korneas jo më pak se 2;
- dëmtimi i iridit jo më pak se 1;
- skugje e konjuktivës jo më pak se 2.5;
- edeme e konjuktivës jo më pak se 2.

3.3 Klasifikimi, në bazë të efekteve të veçanta në shëndetin e njerëzve, duke zbatuar limitet e përqëndrimit për vlerësimin e këtij rreziku.

3.3.1 Në zbatim të ligjit "Për substancat dhe preparatet kimike", vlerësimi i rrezikut të një kimikati ose të një preparati për shëndetin e njeriut bëhet me metodat tradicionale, duke përdorur përqëndrimet limite, individuale të preparatit.

Në këtë rast preparatet vlerësohen:

a) shumë toksike (përsa i përket efekteve letale të tyre), kur këto përmbajnë një ose shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara shumë toksike dhe përqëndrimet e tyre kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr. 2;

Përqëndrimet limit, të dhëna në tabelën nr.2, përcaktojnë klasifikimin e preparatit në lidhje me përqendrimin individual të substancës (substancave) të pranishme.

Tabela nr. 2

Klasifikimi i substancës		Klasifikimi i preparatit	
	T +	T	Xn
T+ R26, R27,R28	Përqëndrimi > 7%	1% përqëndrim<7%	0,1 $\leq$ %përqëndrim<1%
T R 23, R24, R25		përqendrimi $\geq$ 25%	3%$\leq$ përqendrim< 25%
Xn			Përqëndrimi $\geq$ 25%

R20, R21, R22			

Vlerësimi i të gjitha efekteve të dëmshme për shëndetin, shprehet me anën e përqendrimeve limit së bashku me klasifikimin e substancës, simboli i të cilit jepet me treguesin e natyrës së rrezikut.

b) toksike (përsa i përket efekteve letale të tyre), kur këto preparate përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara si shumë toksike ose toksike, përqëndrimet e të cilave kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr. 2.

c) të dëmshme toksike, (përsa i përket efekteve letale të tyre) kur këto preparate përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara si shumë toksike, të cilat kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr. 2.

ç) shumë korrozive, kur këto preparate përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara si korrozive të shënuara me treguesin e rrezikut R35, përqëndrimet e të cilave kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr. 3.

d) korrozive, kur këto preparate përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara si korrozive, të shënuara me treguesin e rrezikut R34, përqëndrimet e të cilave kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr 3.

Tabela nr. 3

Klasifikimi i substancës dhe treguesi standard i rrezikut	Klasifikimi i preparatit dhe treguesi standard i rrezikut			
	C R35	C R 34	Xi R41 .	Xi R 36,R37,R38
C R 35	përqëndrimi $\geq$ 10 % R 35 e detyruar	5% $\leq$ përqëndrimi < 10 % R 34 e detyruar		1% $\leq$ përqëndrimi <5% R 36, R38 e detyruar
C R 34		përqendrimi $\geq$ 10 % R34 e detyruar		5% $\leq$ përqëndrim $\leq$10 % R 36, R38
X i R41			përqëndrimi $\geq$ 10 % R41 e detyruar	5% $\leq$ përqëndrim <10 % R 36 e detyruar
Xi R 36,R37,R38				Përqëndrim $\geq$ 20 % R36,R37,R38 e detyruar në bazë të përqëndrimit në fjalë për substancat e rrezikshme

dh) irritues të lëkurës, kur këto preparate përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara si korrozive ose irrituese të shënuara me treguesin e rrezikut R 38, përqëndrimet e të cilave kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr.3.

e) shumë të dëmshme për sytë, kur këto preparate përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara si irrituese të shënuara me treguesin e rrezikut R41, përqëndrimet e të cilave kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr.3.

ë) irritues për sytë, kur këto preparate përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose të vlerësuara si irrituese, të shënuara me treguesin e rrezikut R41 ose R36, përqëndrimet e të cilave kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr.3.

Për preparatet e gazta, përqëndrimet limite të shprehura në përqindje vëllim/vëllim jepen sipas tabeles 2/A.

Tabela nr. 2/A

Klasifkimi i Substancës (gaz)	Klasifikimi i preparatit të gaztë		
	T +	T	Xn
T + R26, R27, R28	Përqëndrimi ≥ 1 %	0,2%≤ përqëndrimi < 1 %	0,02%≤ përqëndrimi < 0,2
T R23, R24, R25		përqëndrimi ≥ 5 %	0,5%≤ përqëndrimi < 5 %
X n R20, R21, R22			Përqëndrimi ≥5%

- Për gazet (preparatet e gazta) që shkaktojnë këto efekte (R34, R35 ose R36, R37, R38, -R41) përqëndrimet limite individuale, të përcaktuara, të shprehura në përqindje vëllim/vëllim, jepen në tabelën nr. 3/A.

Tabela nr. 3/A

Klasifikimi i substancës (gaz)	Klasifikimi i preparatit dhe treguesi standard i rrezikut			
	C R 35	C R 34	Xi R41	Xi R 36, R37,R38
C R 35	(cc) ≥ 1 % R 35 e detyruar	0.2%≤ (cc) < 1 % R 34 e detyruar		0.02%≤(cc) <0,2% , R 37/38 e detyruar
C R 34	(cc) ≥ 5% R 34 e detyruar			0,5% ≤ (cc)<5 % R 37/38 e detyruar
X i R41			(cc) ≥ 5% R 41 e detyruar	0,5%≤ (cc) <5% R 36 e detyruar
Xi R 36,R37,R38				(cc) ≥ 5% R36,R37,R38 e detyruar

Shënim: (cc)- përqëndrimi i preparatit

f) sensibilizuese, kur substancat që shkaktojnë këto efekte përcaktohen si sensibilizuese dhe shënohen me:

- simbolin Xn dhe treguesin e rrezikut R42, në qoftë se ky efekt shkaktohet me frymëmarrje;
- simbolin Xi dhe treguesin e rrezikut R 43, në qoftë se ky efekt shkaktohet në kontakt me lëkurën;
- simbolin Xn dhe treguesin e rrezikut R42/43, në qoftë se ky efekt shkaktohet me frymëmarrje dhe në kontakt me lëkurën.

Përqëndrimet individuale limit jepen në tabelën nr. 3/B.

Tabela nr. 3/B

Klasifikimi i substancës	Klasifikimi i preparatit	
	Sensibilizuese me R 42	Sensibilizuese me R 43
Sensibilizuese me R 42	(cc) ≥ 1 % R 42 e detyruar	
Sensibilizuese me R 43		(cc) > 1 % R 43 e detyruar
Sensibilizuese me R42/43	(cc) ≥ 1 % R 42/43 e detyruar	

Për preparatet e gazta, këto lëndë klasifikohen si sensibilizuese dhe shënohen me:

- simbolin Xn dhe treguesin R42, nëse ky efekt shkaktohet me frymëmarrje;
- simbolin Xn dhe treguesin R42/43, nëse ky efekt shkaktohet me frymëmarrje dhe nëpërmjet

kontaktit me lëkurën.Përqendrimet limit të tyre jepen sipas tabelës nr. 3/C.

Tabela nr. 3/C

Klasifikimi i substancës	Klasifikimi i preparatit të gaztë	
	Sensibilizuese me R 42	Sensibilizuese me R 43
Sensibilizuese me R 42	(cc) ≥ 0,2 % R 42 e detyruar	
Sensibilizuese me R42/43	(cc) ≥ 0,2 % R 42/43 e detyruar	

g) Preparatet vlerësohen si irritues për sistemin e frymëmarrjes, kur këto përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara ose vlërësuara si irritues, shënuar me treguesin e rrezikut R37 kur në përqendrime individuale kalojnë përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr. 3.

gj) Preparatet vlerësohen si kancerogjene dhe shënohen me simbolin dhe treguesin e rrezikut "toksik", në rast se ato përmbajnë një substancë që shkakton këto efekte, të shënuar me treguesin e rrezikut standard R45, ose R49, që tregon substanca kancerogjene të kategorisë 1 dhe kategorise 2 me përqëndrim të barabartë ose që kalon përqëndrimin e përcaktuar të substancave në tabelën nr.4.

j) Preparatet vlerësohen si të dyshimta për njerëzit për sa i përket efekteve të mundshme kancerogjene të tyre dhe shënohen me simbolin dhe treguesin e rrezikut "i dëmshëm", kur ato përmbajnë një substancë që shkakton këto efekte, të shënuar me treguesin e rrezikut standard R40, e cila tregon substancë kancerogjene të kategorisë 3, në përqendrim të barabartë ose që kalojnë përqëndrimin e substancave të përcaktuar në tabelën nr.4.

k) Preparatet vlerësohen mutagjene dhe shënohen me simbolin dhe treguesin e rrezikut "toksik", kur ato përmbajnë një substancë që shkakton këto efekte, të shënuar me treguesin e rrezikut standard R46, që tregon substancë mutagjene të kategorisë 1, në përqëndrim të barabartë ose që kalon përqendrimin e përcaktuar në tabelën nr.4.

l) Preparatet vlerësohen mutagjene dhe shënohen me simbolin dhe treguesin e rrezikut " i dëmshëm", kur ato përmbajnë një substancë që shkakton këto efekte, të shënuar me treguesin e rrezikut standard R46, që tregon substancë mutagjene të kategorisë 2, në përqëndrim të barabartë ose që kalon përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr.4.

ll) Preparatet vlerësohen të dyshimta për njerëzit, për shkak të efekteve të mundshme mutagjene, të shënuar me simbolin dhe treguesin e rrezikut "i dëmshëm" kur ato përmbajnë një substancë që shkakton këto efekte, të shënuar me treguesin e rrezikut standard R40, që tregon substancë mutagjene të kategorisë 3, në përqëndrim të barabartë ose që kalon përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr.4.

m) Preparatet vlerësohen teratogjene dhe shënohen me simbolin dhe treguesin e rrezikut "toksik",kur ato përmbajnë një substancë që shkakton këto efeket, të shënuar me treguesin e rrezikut standard R60, që tregon substancë teratogjene të kategorive 1,2, në përqëndrim të barabartë ose që kalon përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr.4.

n) Preparatet vlerësohen teratogjene dhe shënohen me simbolin dhe treguesin e rrezikut "toksik", kur ato përmbajnë një substancë që shkakton këto efekte, të shënuar me treguesin e rrezikut standard R62, që tregon substancë teratogjene të kategorisë 2, me përqëndrim te barabartë ose që kalon përqëndrimin e përcaktuar në tabelën nr.4.

Në vlerësimin e rrezikut, në bazë të përqëndrimeve të preparatit ose kimikatit, nuk merren në konsideratë vlerësimi i substancave, të cilat vlerësohen si papastërti ose shtesa, kur përqëndrimi i tyre në peshë është më pak se:

0,l për qind për substancat e klasifikuara si shumë toksike ose toksike;

1 për qind për substancat e klasifikuara si të dëmshme, korrozive ose irrituese.

o) Preparatet vlerësohen eksplozive, oksiduese, ekstremisht të ndezshme, shumë të ndezshme ose të ndezshme, kur rezultatet e testeve të kryera përputhen me përcaktimet e projektligjit "Për substancat dhe preparatet kimike". Klasifikimi i tyre si eksplozive, oksiduese, ekstremisht të ndezshme, shumë të ndezshme ose të ndezshme nuk është i nevojshëm të bëhet kur asnjë nga përbërësit nuk ka veti të tilla dhe, në bazë të informacionit të dhënë nga prodhuesi, preparati nuk paraget rreziqe të këtij lloji.

Në tabelën nr.4 jepen në mënyrë të përmbledhur përqëndrimet limit të substancave dhe të

preparateve sipas vlerësimeve të bëra më lart, nga pika "gj" deri tek pika "n".

Efektet kancerogjene (mutagjene), toksike për riprodhueshmërinë jepen sipas tabelës nr. 4.

Tabela nr 4

Klasifikimi i substancës	Klasifikimi i preparatit	
	Kategoria 1 dhe 2	Kategoria 3
Substanca kancerogjene të kategorisë 1 ose 2 me R 45 ose R49	(cc) ≥ 0,1 kancerogjene R45,R49 e detyruar, Idem dhe për gazet	
Substanca kancerogjene të kategorisë 3 R 40		(cc) ≥ 1 kancerogjene R40 e detyruar Idem dhe për gazet
Substanca mutagjene të kategorisë 1 ose 2 me R46 dhe kategorisë 3 me R 40	(cc) ≥ 0,1 mutagjene R46 e detyruar Idem dhe për gazet	(cc) ≥ 1 mutagjene R40 e detyruar Idem dhe për gazet
Substanca toksike për riprodhueshmërinë e kategorisë 1 ose 2 me R60 (pjellshmëri)	(cc) ≥ 0,5% toksik për riprodhueshmërinë R 60 e detyruar (cc) ≥ 0,2 % për gazet	
Substanca toksike për riprodhueshmërinë e kategorisë 3 me R62		(cc) ≥ 5% toksik për riprodhueshmërinë R62 e detyruar (cc) ≥ 1 % për gazet
Substanca toksike për riprodhueshmërinë të kategorisë 1 ose 2 me R61 (zhvillim)	(cc) ≥ 0,5 toksik për riprodhueshmërinë (zhvillim) R61 e detyruar, (cc) ≥ 0.2 % për gazet	
Substanca toksike për riprodhueshmërinë e kategorisë 3 me R63 (zhvillim)		(cc) ≥ 5% toksik për riprodhueshmërinë (zhvillim) R62 e detyruar (cc) ≥ 1 % për gazet

p) Për preparatet me përbërje kimikatesh (substancash) të njohura me veti toksikologjike, të përcaktuara sipas kritereve të paragrafit të dytë të pikës “n” të këtij vendimi, vlerësimi i ri i rrezikut për preparatin që formohet të bëhet në rast të ndryshimit, në përbërje të përqëndrimit fillestar, si përqindje peshë/peshë të një ose më shumë përbërësve të rrezikshëm, sipas tabelës nr.5.

Tabela nr. 5

Përqëndrimi fillestar i përbërësit	Ndryshimet e lejuara në përqëndrimet fillestare të përbërësit
≤ 2,5 %	± 15%
>2,5 ≤ 10 %	±10 %
>10 ≤ 25%	±6%
>25≤ 50 %	± 5%
>50 ≤ 100 %	± 2,5%

3.4-Klasifikimi dhe vlerësimi i rrezikut të substancave të rrezikshme, në bazë të ndikimeve në mjedis.

Klasifikimi bazohet në cilësitë e substancave dhe të preparateve të rrezikshme lidhur me qëndrushmërinë, degradueshmërinë, bioakumulimin, lëvizshmërinë dhe toksicitetin e tyre.

3.4.1 Kriteret e klasifrkimit, simbolet dhe treguesit e rrezikut

A. Në mjedis ujor

1. Substancat klasifikohen të rrezikshme për mjedisin dhe përcaktohen me treguesin e rrezikut sipas kriterit:

R 50-shumë toksik për organizmat ujorë;

R 51 -toksik për organizmat ujorë;

R 53-mund të shkaktojë për një kohë të gjatë ndikime të dëmshme, në mjediset ujore.

Toksiciteti akut:

- kur për 96 ore LC 50 për peshqit < 1 mg/litër
- ose kur për 48 orë EC 50 për dafniat < 1 mg/litër
- ose kur për 72 orë IC 50 për algat < 1 mg/litër

Toksiciteti akut:

- kur për 96 orë LC për peshqit < 1 mg/litër < LC 50 < 10 mg/litër
- ose kur për 48 orë EC 50 për dafniat < 1 mg/litër < EC 50 < 10 mg/litër

ose kur për 72 orë IC 50 për algat < lmg/litër < IC 50 < 10 mg/litër

2. Substancat do të klasifikohen të rrezikshme për mjedisin dhe përcaktohen me treguesin e rrezikut sipas kritereve të mëposhtme:

R 52 - i dëmshëm për organizmat ujorë

R 53 - mund të shkaktojë për një kohë të gjatë ndikime të dëmshme, në mjedisin ujor

Toksiciteti akut:

- kur për 96 orë LC për peshqit < 10 mg/litër < LC 50 < 100 mg/litër
- ose kur për 48 orë EC 50 për dafniat < 1mg/litër < EC 50 < 100 mg/litër
- ose kur për 72 orë IC 50 për algat < 1 mg/litër < IC 50 < 10 mg/litër

B. Në mjedise joujore

1.Substancat klasifikohen të rrezikshme për mjedisin kur së paku një nga treguesit e rrezikut të mëposhtëm është i përcaktuar sipas kritereve që vijojnë:

- R 54 - toksik për florën
- R 55 - toksik për faunën
- R 56 - toksik për mikroorganizmat e tokës ; -R 57 - toksik për bletët
- R 58 - mund të shkaktojë pas një kohe të gjatë, ndikime të dëmshme në mjedis
- R 59 - i rrezikshëm për shtresën e ozonit.

3.5-Klasifikimi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme, i renditur sipas numurit rendor atomik të elementit

Ky klasifikim i substancave dhe i preparteve të rrezikshme jepet në formën e simboleve E, O, F+,F, T+, T, Xi, Xn dhe treguesit të rrezikut R, të shënuar në përputhje me rreziqet përkatëse për shëndetin. Klasifikimi bazohet në udhëzimin e Komitetit Europian nr.67/548/EEC, sipas të cilit për çdo element jepet simboli i rrezikut, treguesi i rrezikut dhe këshillat e sigurisë.

Klasifikimi është bërë për 82 elemente kimike e 14 hidrokarbure dhe jepet në aneksin nr.3.

4. Ambalazhimi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme

4.1 Prodhuesi, importuesi dhe shpërndaresi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme mund t'i hedhë në treg ato, nëse siguron që nga ambalazhimi i substancës dhe i preparatit të rrezikshëm këto rrjedhin dhe nuk përbëjnë rrezik për dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mjedisit.

4.2 Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme për ambalazhet që përdor duhet të ketë parasysh këto kërkesa:

a) Ambalazhi të jetë i ndërtuar në mënyrë të tillë që përmbajtja të mos rrjedhë spontanisht.

b) Materiali përbërës i ambalazhit dhe mbyllësat të mos ndikohen nga përmbajtja e ambalazhuar dhe le mos formojë komponime të rrezikshme me këtë përmbajtje.

c) Në kushte normale pune, ambalazhi të jetë rezistent ndaj dëmtimeve dhe të jetë i siguruar që të mos ndodhin zbërthime spontane të mbyllësve.

ç) Mbyllësat që përdoren në mënyrë të përsëritur të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që pas hapjes të mbyllen dhe të sigurojnë që përmbajtja e ambalazhit të mos rrjedhë.

d) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të etiketuara si shumë helmuese, helmuese, korrozive të destinuara për shitje me pakicë, të pajisen me mbyllësa rezistues, që të mos hapen nga fëmijët.

dh) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të etiketuara si të dëmshme

për shëndetin, ekstremisht të ndezshme, shumë të ndezshme, të destinuara për shitje me pakicë, të pajisen me paralajmërues të prekshëm nga të verbërit.

e) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të ndryshojnë nga ambalazhet që përdoren normalisht për ushqimet, ujin e pijshëm, produktet mjekësore.

ë) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të ofruar për shitje publikut të gjerë, nuk duhet të kenë:

- formë ose dekoracione që tërheqin a nxitin kuriozitetin e fëmijëve dhe të konsumatorëve të paorientuar;

- paraqitje ose vizatim, të përdorura për produkte ushqimore që përdoren për njerëzit, kafshët, produkte mjekësore ose kozmetike.

4.3 Prodhuesi, importuesi dhe shpëndarësi i substancave dhe të preparateve të rrezikshme të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që ambalazhet të cilët mbajnë këto materiale, të ofruar për shitje publikut të gjerë, të jenë të pajisura me shenja të dukshme, paralajmëruese për rrezikun.

5. Etiketimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme

5.1 Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi mund të hedhin në treg substanca dhe preparate të rrezikshme, vetëm nëse ato kanë etiketën ku shënohen të dhënat për vetitë e tyre të rrezikshme, sipas këtij vendimi.

5.2 Etiketa e ambalazhit të substancave të preparateve të rrezikshme të hedhura në treg, duhet të jetë shkruar qartë dhe e lexueshme, në gjuhën shqipe dhe të përmbajë:

a) emrin kimik të substancës ose të preparatit;

b) emrin, mbiemrin (emrin e shoqërisë), rezidencën dhe numurin e telefonit të prodhuesit, importuesit dhe personit që hedh në treg substancën ose preparatin e rrezikshëm;

c) simbolet e rrezikut sipas kodeve të mëposhtme:

(E) - Eksploziv: një bombë që shpërthen;

(O) - Djegës (oksidues i lëndëvë të djegshme): një flakë mbi një rreth;

(F^+)- Ekstremisht i ndezshëm: një flakë;

(F) - Lehtësisht i ndezshëm: një flakë;

(T^+) - Shumë helmues: një kafkë mbi kocka të kryqëzuara;

(T) - Helmues: një kafkë mbi kocka të kryqëzuara;

(Xn) -I dëmshëm: një kryq;

(C) - Korrodues figura e veprimit të një acidi;

(Xi) -Irritues: një kryq në formën e X;

(Xn) - I rrezikshëm për mjedisin;

(N) -I rrezikshëm për mjedisin: Kodi N;

ç) Shenjat e rrezikut specifik (natyra e rreziqeve) të substancës ose të preparatit të rrezikshëm, të cilat të shënohen në etiketë duke iu referuar treguesit (R), si kod, shkronjë, numër dhe fjalë.

d) Instruksionet e kujdesit (rregullat e sigurisë) për përdorimin e lëndëve dhe ndihmën e parë mjekësore, të cilat të shënohen me treguesin (S).

dh) Sasinë nominale (masën ose vëllimin nominal) të përmbajtjes, në rastin e preparateve që përdoren për shitje të gjerë në publik.

5.3 Etiketa e ambalazhit të substancave dhe të preparateve të rrezikshëm nuk duhet të përmbajë të dhëna të tjera për rrezikun, përveç atyre të përcaktuara në pikën 5.2.

5.4 Substancat dhe preparatet e rrezikshme të klasifikuara, ambalazhuara dhe etiketuara sipas këtij vendimi, nga prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi, mund të hidhen në treg nga një person juridik, i autorizuar të kryejë veprimtari tregtare, vetëm me ambalazhin dhe etiketën origjinale të prodhimit dhe importimit ose të riambalazhuara dhe etiketuara nga shpërndarësi, sipas këtij vendimi.

5.5 Për reklamën dhe ofertën e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi janë të detyruar të përdorin veçoritë dalluese dhe simbolet respektive të vetive të rrezikshme të këtyre substancave.

5.6 Detyrimi i vendosjes së simbolit (T) në etiketë bën të padetyrushëm vendosjen e simboleve (X) dhe (C).

5.7.Detyrimi i vendosjes së simbolit (C) në etiketë bën të padetyrueshëm vendosjen e simbolit (X).

5.8 Detyrimi i vendosjes së simbolit (E) në etiketë bën të padetyrushëm vendosjen e

simboleve (F) dhe (O).

5.9 Ambalazhi shoqërohet me rregulla të sigurisë për përdorimin e preparatit, vetëm në rastet kur është e pamundur fizikisht vendosja e tyre në etiketë ose në vetë ambalazhin.

Për preparatet oksiduese, shumë të ndezshme dhe të ndezshme nuk është e nevojshme të jepet një kujtesë për rreziqet e veçanta ose rregullat e sigurisë, në rastin kur përmbajtja e ambalazhit nuk i kalon 125 ml. E njëjta gjë zbatohet në rastin e preparateve irrituese, me përjashtim të rasteve kur preparatet përmbajnë substanca që shkaktojnë sensibilizim.

5.10 Të dhënat e tilla, si "Jo toksike", "Jo i dëmshëm" ose një deklarim tjetër që tregon se preparati nuk është i rrezikshëm nuk duhet të figurojnë në etiketë ose mbi ambalazhet e lëndëve, që përcaktohen nga ky vendim.

5.11 Kur një preparat përmban qoftë dhe vetëm një substancë, për të cilën sipas udhëzimeve vendoset shënimi "Kujdes - substancë ende e patestuar plotësisht", etiketa e preparatit duhet të mbajë shënimin "Kujdes, ky preparat përmban një substancë ende të patestuar plotësisht", nëse substanca e pranishme ka përqëndrim të barabartë ose më të lartë se l për qind.

5.12 Kur një prodhues mund të vërtetojë që zbulimi i identitetit kimik në etiketën e preparatit të një substance të rrezikshme do të rrezikonte natyrën konfidenciale të pronës së tij, ai lejohet t'i referojë kësaj substance një emër që tregon grupet kimike funksionale më të rëndësishme ose një emër alternativ.

Në këto raste, prodhuesi njofton Zyrën e Rregjistrimit të Kimikateve të Rrezikshme, e cila njofton autoritetet e shtetit ku preparati është hedhur në treg.

5.13 Kur specifikimet e përmendura më sipër vendosen në një etiketë, ajo fiksohet në mënyrë të dukshme në një ose më shumë faqe të ambalazhit, në mënyrë që të lexohet horizontalisht, kur ambalazhi është i vendosur në pozicion normal.

5.14.Përmasat e etiketës të jenë si më poshtë vijon:

Kapaciteti i ambalazhit	Përmasat, në mm të etiketës
a) Ambalazh $\leq$ 3 litra	mundësisht së paku 52 x 74
b) 50 litra $\geq$ Ambalazh > 3 litra	jo më e vogël se 74 x 105
S:11-22-29-38-65

2. Kripërat e bariumit, përjashtuar sulfatin e bariumit

Xn
R:54
S: 21-31-51-91

(80) Mërkuri

1. Mërkuri dhe komponimet e tij, përjashtuar klorurin mërkuror (kalomelani) sulfurin e mërkurit dhe fulminatin e mërkurit

T
R:52-58-83
S: 3-12-21-31-63-72-74-9-108

2.Kloruri i mërkurit

Xn
R:54
S:11-31

3. Oksicianuri i merkurit

E,T
R:1-52
S: 6-11-21-28-29-31-32-36-63-76-91-108

4. Fulminati i mërkurit

E,T
R:3-52
S: 6-11-21-25-28-29-36-41-59-72-108

(81) Taliumi

1. Komponimet e taliumit

E T
R:52-56

S: 3-11-21-31-51-65-91-108

(82) Plumbi

1. Komponimet e plumbit, përjashtuar komponimet alkalike të plumbit,azoturi i plumbit dhe trinitrorezorcinati i plumbit

Xn
R:58
S:11-21-31-51-91

2. Komponimet alkilike të plumbit

T
R:58
S:11-21-31-63-71-73-74-92-108

3. Azoturi i plumbit.

E
R:3-54
S:6-11-21-25-27-28-29-36-41-51-59-72

(601) Hidrokarburet

1. Metani

F
R:22-34
S:16-22-32-33-37-104

2. Etani

F
R:25-34
S:15-22-34-36-104

3. Propani

F
R:25-34
S:15-22-34-36-104

4. Butani

F
R:25-34
S:15-22-34-36-104

5. Dimetilpropani

F
R:25-34
S:15-22-34-36-104

6. Pentano dhe izopentani (metil-butani)

F
R:22 33
S:15-22-23-27-36-53

7. Heksani

F
R:22-33
S: 1 5-22-23-27-36-53-71-104

8. Heptani

F
R:22-33
S:15-22-23-27-36-53-71-104

9. Oktani

F
R:22-33
S:15-22-23-27-36-53-71-104

10.Eteril (Etilen)

F
R:25-34
S:15-22-34-36-104
11. Properil (Propilen)
F
R:25-34 S:15-22-34-36-104
12. Butileni
F
R:25-34
S:15-22-34-36-104
13. Butilen-1,3
F
R:25-34
S:15-22-34-36-104
14.Izopropen
F
R:22-33
S:15-22-23-27-36-53-71-104

Shënim:

- Hidrokarburet dhe derivatet, për arsye të numrit të madh të tyre, janë objekt i një klasifkimi të posaçëm.
- Kjo është lista e disa kimikateve të rrezikshme, hartuar dhe klasifikuar nga BE-ja, sipas Aneksit 1 të Udhëzimit 67/548/EEC, e cila është e përdorshme edhe sot.
- Komisioni i KE-ja ka publikuar në Fletoren Zyrtare të Komunitetit Europian listën e kimikateve të reja të cilat janë shpallur sipas direktivës ELINCS.

VENDIM
Nr.36, datë 19.12.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Zija Vuci	Anëtar i	“	“
Gjergj Sauli	Anëtar i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën, 30.10.2003 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.37 Akti që i përket:

KËRKUES: PIRO E ILIR RUDHA, përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta, me prokurë.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. HASAN BLACERI, përfaqësuar nga avokat Fatos Lulo, me prokurë.
2. SEFER, SALI, RIZA E SHEFQET LIKA.
3. ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, NË MUNGESË.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr.1958, datë 25.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1252, datë 1.11.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1384, datë 27.12.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesit kanë pretenduar se vendimet gjyqësore janë rezultat i zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor, i cili konsiston në këto drejtime kryesore:

- Gjykatat kanë disponuar mbi objektin e padisë, sepse kanë ndryshuar shkakun juridik pa kërkesë të palëve, duke cenuar parimin e paanësisë.
- Gjykatat kanë legjitimuar paditësin, megjithëse ai në padi nuk kërkon mbrojtje të drejtpërdrejtë të të drejtave të tij subjektive, por mbrojtje të të drejtave të personave të tjerë, nga të cilët mund të pretendojë të fitojë më pas këto të drejta.
- Gjykatat nuk kanë zbatuar drejt dispozitat procedurale dhe materiale për mënyrat e fitimit të pronësisë dhe për marrjen e provave.
- Në vendimin e Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë nuk janë pasqyruar problemet ligjore të ngritura në rekurs, gjë që tregon se ai kolegj na ka mohuar të drejtën e debatit për kërkimin tonë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tëresi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1958, datë 25.05.2001, ka pranuar padinë e subjektit të interesuar Hasan Blaceri, duke konstatuar si të pavlefshme kontratën e dhurimit për një sipërfaqe toke të lidhur midis subjekteve të interesuara Sefer, Sali, Riza e Shefqet Lika si dhurues dhe kërkuesit Ilir Rudha, si përfitues nga dhurimi, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Gjykata e rrethit ka konstatuar gjithashtu si të pavlefshme kontratën e dhurimit të banesës të lidhur midis kërkuesve, duke detyruar kërkuesin Ilir të njohë bashkëpronar mbi banesën, subjektin e interesuar Hasan Blaceri.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1384, datë 27.12.2002, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Ilir Rudha.

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se pretendimet e kërkuesve që gjykatat e të tria shkallëve kanë zhvilluar proces jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës, nuk janë të bazuara.

Për konstatimin si të pavlefshme të veprimeve juridike, kontratave të dhurimit të 775 m^2 truall dhe të një banese, gjykatat kanë marrë provat dhe kanë bërë interpretimin e Kodit Civil për dispozitat për pavlefshmërinë e veprimeve juridike. Përcaktimi si shkak juridik për anulimin e kontratës së dhurimit të truallit nenin 92 shkronjat "b" e "c" të Kodit Civil (veprim juridik me mashtrim të ligjit apo fiktiv) dhe jo nenin 94/ç, siç pretendoi paditësi (veprim juridik duke mashtruar personin), nuk ka të bëjë me procesin e parregullt në kuptimin kushtetues. Ky qëndrim ka të bëjë me vlerësimin juridik të atyre rrethanave e provave të parashtruara nga palët për të cilat janë kompetente gjykatat e sistemit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese nuk gjen elementet e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues edhe përsa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave procedurale e materiale për mënyrën e fitimit të pronësisë. Gjykata Kushtetuese nuk shqyrton mënyrën e interpretimit të ligjit e as mënyrën e vlerësimit e analizën e provave të administruara në proceset gjyqësore, sepse ato janë çështje që u përkasin gjykatave të sistemit gjyqësor. Parregullsitë e gjykimit e bëjnë procesin jo të rregullt në kuptimin kushtetues, kur ato cenojnë parimet themelore të gjykimit dhe që lidhen me të drejtat themelore të shtetasve.

Përsa i përket pretendimit tjetër, sipas të cilit subjekti i interesuar nuk legjitimohet t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar pavlefshmërinë e kontratave të lidhura midis personave të tjerë, rezulton se ai

ka interes, përderisa pretendon cenimin e të drejtave të tij dhe për këtë i është drejtuar gjykatave. Është në kompetencën e këtyre të fundit të bëjnë interpretimin e normave juridike për shkakun juridik dhe objektin e padive që duhen ngritur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.37, datë 22.12.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i" "
Gjergj Sauli	Anëtar i" "
Alfred Karamuço	Anëtar i" "
Kristofor Peçi	Anëtar i" "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i" "
Petrit Plloçi	Anëtar i" "
Sokol Sadushi	Anëtar i" "

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 20.11.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40 Akti që i përket:

KËRKUES: ISMAIL, XHEVDET, FORTUZ, FETANETE, ENDER, FIORENTINA, EVA, ARBEN, LUMTURI E MARJETA NELAJ; TEUTA, ENGJËLLUSHE, SEIT, AGRON, PELLUMB E SKËNDER MEHMETI; SIRMADE BEQO, të gjithë përfaqësuar nga avokat Flamur Progonati, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. MINISTRIA E DREJTËSISË, në mungesë.
2. KOMISIONI I KTHIMIT TË PRONAVE PRANË PREFEKTURËS SË QARKUT TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr.760, datë 27.2.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.672, datë 5.6.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.854, datë 8.5.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit pretendojnë se gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor. Ata kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore:

- Gjykimi i kësaj çështjeje është bërë duke thirrur si palë të paditur Marjeta Nelaj, e cila është e mitur dhe nuk gëzon zotësinë juridike për të vepruar. Mbrojtja e saj duhej të ishte e detyrueshme nga përfaqësuesi ligjor.
- Është shkelur e drejta e palëve për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar. Në gjykim kanë marrë pjesë vetëm disa prej kërkuesve, ndërkohë që për të tjerët nuk janë respektuar kërkesat procedurale për njoftimet. Gjykata ishte e detyruar t'i kërkonte palës paditëse saktësimin e adresave për të padituri.

- Nuk u është njoftuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë palëve që kanë qenë në mungesë në gjykim, shkelje kjo e neneve 443 e 444 të Kodit të Procedurës Civile.

- Gjykata e shkallës së parë ka marrë rolin e ekspertit duke vlerësuar truallin si të zënë. Ajo ishte e detyruar të thërriste ekspert në seancë gjyqësore.

- Gjykatat nuk kanë qenë të paanshme në zgjidhjen e çështjes. Kërkuesit kanë kërkuar që çështja të transferohet në një gjykatë tjetër, për arsye se të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Tiranë nuk mund ta gjykonin me paanshmëri këtë çështje, sepse trualli, objekt gjykimi, i ishte dhënë për ndërtim Ministrisë së Drejtësisë, që e kishte planifikuar për të ngritur ndërtesën e Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Kërkuesit pretendojnë të njëjtat shkelje edhe për gjykimin në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, kërkuesit pretendojnë se antikushtetutshmëria e këtij vendimi qëndron në moskalimin padrejtësisht të kësaj çështjeje në seancë gjyqësore, ndërkohë që shkaqet për kalimin kanë qenë ligjore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesve dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi padinë e ngritur nga Ministria e Drejtësisë, me vendimin nr.760, datë 27.2.2002, ka vendosur: “anulimin pjesërisht të vendimit nr.19, datë 30.3.2001 të Komisionit të Kthimit të Pronave për pjesët 1/a dhe 1/b të sipërfaqes së truallit prej 16.900 m^2, e cila i është njohur dhe kthyer ish-pronarit Qazim Nelaj.

Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke saktësuar kufizimet e sipërfaqes së pronës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur.

Nga të gjitha pretendimet që kanë parashtruar kërkuesit, Gjykata Kushtetuese vlerëson se disa prej tyre janë të rëndësishme për t’u analizuar dhe vlerësuar, në raport me elementet thelbësore që përfshihen në kuptimin kushtetues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i pretendimeve të kërkuesve, si dhe i pasqyrimit që ato gjejnë në materialet e dosjes gjyqësore, rezulton se gjykatat në shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk kanë respektuar standardet ligjore dhe kushtetuese, që kanë të bëjnë me prezencën e palëve në gjykim, si dhe nuk kanë vlerësuar ato elemente të rëndësishme që duhet të garantojnë paanshmërinë e saj në zhvillimin normal të procesit gjyqësor.

Që në fillim të procesit, gjykata e shkallës së parë ka lejuar disa shkelje procedurale që lidhen me mënyrën e hartimit dhe të paraqitjes së kërkesëpadisë, si dhe me mossaktësimin e adresave të palës së paditur. Mosplotësimi i këtyre kërkesave formale të ligjit procedural nga ana e gjykatës ka qenë shkaku kryesor që pala e paditur, të cilët kanë qenë në një numër të konsiderueshëm si pronarë të pronës objekt gjykimi, të mos vihen në dijeni se ndaj tyre ka filluar një proces civil. Lejimi i këtyre shkeljeve ligjore procedurale ka sjellë cenimin e një elementi të rëndësishëm kushtetues, që lidhet me të drejtën e palës për të qenë e pranishme për t’u dëgjuar, për të parashtruar pretendimet dhe për të realizuar mbrojtjen në një proces gjyqësor. Kështu, nga 17 persona që kanë qenë si të paditur në këtë gjykim, gjykata ka zhvilluar procesin në mungesë të 4 prej tyre, ndërkohë që në dosje nuk vërtetohet me asnjë dokument njoftimi për seancat gjyqësore. Konkretisht, për të paditurit Ender Nelaj, Eva Nelaj, Arben Nelaj dhe Seit Mehmeti, për të cilët fletëthirrjet pasqyrojnë adresat e pasakta, nuk vërtetohet që të jetë komunikuar njoftimi për gjykim me një nga format e tjera që parashikon Kodi i Procedurës Civile. Kështu që i gjithë procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të tyre.

Elemente të parregullsisë së njoftimeve për zhvillimin e seancave gjyqësore apo të mos prezencës së palës së paditur në proces konstatohen në dosjen gjyqësore edhe për të paditurit e tjerë. Kështu, në seancën e datës 7.2.2002, megjithëse i padituri Fortuz Nelaj ka paraqitur një shkak të arsyeshëm për shtyrjen e seancës gjyqësore, trupi gjykues ka lejuar zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij. Gjithashtu, në përfundim të procesit dhe me shpalljen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se personat e sipërcituar nuk kanë qenë të pranishëm dhe as nuk janë vënë në dijeni të përmbajtjes së këtij vendimi. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se personat e panjoftuar për seancat

gjyqësore apo për vendimin përfundimtar nuk e kanë ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë apo në Gjykatën e Lartë.

Pretendimin tjetër të kërkuesve se është prekur parimi i paanshmërisë në gjykim në aspektin se njëanshmëria e gjykatës ka rezultuar për arsye të mostransferimit të çështjes në një gjykatë tjetër dhe të interesit që kishin të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese e konsideron si të pabazuar për të arsyetuar shkeljen e këtij parimi kushtetues. Fakti se objekti i kërkesëpadisë lidhej me truallin ku do të ngrihej godina e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar arsye serioze të njëanshmërisë së trupit gjykues. Për të vërtetuar shkeljen e parimit të paanshmërisë në një proces gjykimi duhet dalluar qëndrimi subjektiv, në të cilin bëhen përpjekje për t'u siguruar lidhur me bindjen personale të një gjyqtari në çështjen konkrete, si dhe qëndrimi objektiv, i cili përqëndrohet në vlerësimin e garancive të mjaftueshme që mënjanojnë çfarëdolloj dyshimesh që janë të justifikueshme në këtë sferë.[1] Këtij argumenti të përdorur në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, Gjykata Kushtetuese i ka qëndruar në të gjithë praktikën e saj.

Në çështjen në shqyrtim, pala e paditur ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit dhe më pas transferimin e çështjes në një gjykatë tjetër, kërkesa për të cilat, pasi janë shqyrtuar, është vendosur rrëzimin i tyre si të pabazuara në ligj. Pra, pretendime të tilla janë bërë objekt shqyrtimi nga gjykata dhe për motive të përligjura nuk janë pranuar. Me vendimet që janë marrë, nuk konkludohet se gjykata duhet të ketë qenë e njëanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Gjykata Kushtetuese krijon bindjen se paanësia në këtë proces gjyqësor nuk është cenuar në këto drejtime që parashtron kërkuesi, por në qëndrimet subjektive që gjykata ka mbajtur gjatë ecurisë së procesit, duke lejuar kryerjen apo edhe moskryerjen e atyre veprimeve të domosdoshme procedurale që lidhen me hartimin e kërkesëpadisë, me njoftimet apo me dijeninë e palëve për gjykimin. Këto qëndrime të mbajtura nga ky trup gjykues kanë krijuar dyshime të arsyeshme te pala e paditur se gjykata, në zgjidhjen e kësaj çështjeje, nuk do të paraqitej e paanshme.

Përsa i përket pretendimeve të tjera që kanë parashtruar kërkuesit, Gjykata Kushtetuese nuk i çmon si të rëndësishme dhe thelbësore për të konkluduar mbi shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për thirrjen e të miturës në proces si palë e paditur pa praninë e përfaqësuesit të saj ligjor, rezulton nga vendimi gjyqësor se në këtë gjykim është thirrur me cilësinë e palës së paditur nëna e saj.

Mbi bazën e këtyre argumenteve të paraqitura arrihet në përfundimin se në çështjen në shqyrtim, gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. I njëjti konkluzion arrihet edhe për gjykimet e zhvilluara në gjykatën e apelit dhe në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, të cilat janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, sepse me shkeljet e lejuara ato kanë cenuar të drejtën kushtetuese të kërkuesve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja "f", si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr.760, datë 27.2.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.672, datë 5.6.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.854, datë 8.5.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

[1] Vendimi De Cubber-i kundër Belgjikës / 24 tetor 1984;A 86

V E N D I M
Nr.38, datë 23.12.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPERISE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i " "
Alfred Karamuço	Anëtar i " "
Kristofor Peçi	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 26.9.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.33 Akti që i përket:

KËRKUES: SELAMI ZALLI, përfaqësuar nga avokat Neshat Fana, me deklarim.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
PRESIDENTI I REPUBLIKËS, në mungesë
PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë
OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.3, datë 30.1.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/1 "g", 2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë:
1. Kolegjet e Bashkuara i kanë mohuar të drejtat themelore për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës.
2. Kolegjet e Bashkuara kanë cenuar parimin kushtetues të parashikuar në nenin 132/1 të Kushtetutës, sipas të cilit vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Selami Zalli ka kërkuar në gjykatë anulimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr.3037, datë 1.6.2001 për transferimimin e tij nga prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme në prokuror në Prokurorinë e Rrethit Pogradec.
Gjykata e Apelit Tiranë e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë dhe me vendimin nr.97, datë 18.9.2002 ka shfuqizuar pikën 4 të dekretit, lidhur me transferimin e kërkuesit, me arsyetimin se ai ka të drejtë të mbrohet në gjykatë, përderisa transferimi ka cenuar elementet e

marrëdhënies juridike të punës, si: paga e vendi i punës.

Pas rekursit të Prokurorit të Përgjithshëm, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.3, datë 30.1.2003, kanë vendosur prishjen e vendimit nr.97, datë 18.9.2002 të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Kolegjet e Bashkuara kanë vendosur pushimin e gjykimit, duke arsyetuar se dekretet e Presidentit të Republikës, duke përfshirë edhe ato të largimit apo transferimit nga detyra të prokurorëve, nuk mund të kundërshtohen në gjykatë, pasi ato janë të natyrës juridiko-kushtetuese dhe jo akte administrative. Ato kanë arsyetuar gjithashtu se Kushtetuta nuk parashikon për prokurorët ndonjë mjet juridik kundërshtimi, përderisa qëndrimi i tyre në detyrë bazohet në një vendimmarrje të karakterit diskrecional të Presidentit të Republikës.

Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, sepse i ka mohuar prokurorëve të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj dekreteve të Presidentit.

Kolegjet e Bashkuara i konsiderojnë aktet e Presidentit për largime nga puna si akte me karakter juridiko-kushtetues, e jo administrativ. Ky arsyetim është në kundërshtim me frymën e përmbajtjen e legjislacionit, me jurisprudencën kushtetuese e doktrinën e së drejtës administrative. Natyra juridike e aktit përcaktohet në radhë të parë nga marrëdhënia që rregullon dhe nga lloji i veprimtarisë që ushtron organi që e nxjerr. Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë del se veprimtaria e Presidentit të Republikës si kryetar shteti ka elemente të tre pushteteve: legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. Për këtë arsye, Ai ka kompetencë të nxjerrë si akte që janë shprehje e drejtimit politik, ashtu edhe akte (dekrete) individuale që për nga natyra e tyre, afrojnë më shumë me veprimtarinë ekzekutive urdhërdhënëse të administratës shtetërore. Në aktet me karakter administrativ përfshihen edhe dekretet për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve, që mund të cenojnë të drejtat juridiko-civile të prokurorit. Duke pasur të tilla cilësi, dekreti, ashtu siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.25, datë 13.2.2002 duhet të jetë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu se e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta. Kufizimi që i bëhet kësaj të drejte për shkak të përgjegjësisë së veçantë që ata kanë në mbrojtje të interesave publike, nuk gjen mbështetje tek neni 17 i Kushtetutës. Edhe nga përmbajtja e nenit 148 të Kushtetutës, ku përcaktohen detyrat e prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzave në gjyq etj., si dhe nga vetë kuptimi si organ i pavarur, del që prokurorëve duhet t'u jepen të drejta e garanci, siç është edhe e drejta e ankimit ndaj masave që ata i konsiderojnë të padrejta.

Sipas ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", që ka qenë në fuqi deri më 28 nëntor 1998, prokurorët ishin të organizuar e funksiononin brenda pushtetit gjyqësor dhe Gjykata e Lartë, në vendimet e saj, pranonte për shqyrtim ankimet e prokurorëve ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për largimin e tyre nga detyra. Ndonëse në nenin 147/6 të Kushtetutës në fuqi përcaktohet se gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për largimin e tyre nga puna, ndërsa për prokurorët nuk parashikohet ndonjë e drejtë e tillë, kjo nuk do të thotë se prokurorët nuk kanë të drejtën të kërkojnë në gjykatë të drejtat e tyre juridiko-civile. Kushtetuta nuk përcakton për prokurorët ndonjë procedurë të veçantë gjykimi siç bën për gjyqtarët, por nuk i përjashton ata nga e drejta për t'u drejtuar në gjykatë ndaj akteve administrative, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ashtu siç e kanë këtë të drejtë të gjithë personat e tjerë fizikë e juridikë.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr.25, datë 13.2.2001, pranon se e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta dhe se dallimi që mund t'u bëhet atyre nga gjyqtarët e nëpunësit civilë për të drejtën e ankimit cenon frymën dhe përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Duke shkuar më tej, kjo gjykatë, në jurisprudencën e saj, e ka konsideruar të drejtën e ankimit si të lidhur ngushtë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës e nenin 6 të Konventës Europiane.

Gjykata e Lartë i referohet vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut të datës 8.12.1999 në çështjen "Pellegrini" kundër "Francës", në të cilin përjashtohen nga veprimi i nenit 6/1 të Konventës "E drejta për një proces të rregullt", kërkesat e ngritura nga funksionarët, (duke përmendur forcat e armatosura e policinë), detyrimet e të cilave janë karakteristike për administratën që

funksionon si depozituese e pushtetit publik dhe që është përgjegjëse për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit.

Arsyetimi i mësipërm nuk mund të merret si bazë për t'u mohuar prokurorëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Konventa, si instrument i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ofron vetëm një standard minimum të mbrojtjes së të drejtave dhe shtetet nuk pengohen të shkojnë përtej këtij kufiri, duke i njohur funksionarëve të drejtën për t'u ankuar. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e njeh të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës kur shprehet se "neni 6/1 i siguron çdokujt të drejtën të paraqesë ankesa në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykate ose arbitrazhi; në këtë mënyrë, ai ushtron "të drejtën për gjykim", nga e cila e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, që është e drejta për të filluar një proces përpara një gjykate për çështje civile, përbën një aspekt". (Philis kundër Greqisë nr.1, vendimi i 27 gushtit 1991)

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.28 , datë 21.2.2002, ka shfuqizuar pikën 2 të nenit 34 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që mohonte të drejtën e ankimit të prokurorit ndaj dekretit të Presidentit për shkarkimin e tij nga detyra. Ky shfuqizim është bërë si në çdo rast tjetër, nëpërmjet interpretimit të Kushtetutës, i cili ka fuqi "erga omnes" dhe është përfundimtar në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës. Prandaj, zbatimi i këtyre vendimeve është një detyrim kushtetues, të cilin asnjë organ nuk ka të drejtë ta vërë në diskutim.

Në këto rrethana, vendimi nr.3, datë 30.1.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të shfuqizohet. Meqenëse mbetet pa përgjigje rekursi i ushtruar nga Prokurori i Përgjithshëm, çështja i dërgohet për kompetencë Gjykatës së Lartë, e cila, pa i mohuar kërkuesit të drejtën e ankimit, do të ushtrojë kompetencat e veta për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.3, datë 30.1.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.39, datë 23.12.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i " "
Gjergj Sauli	Anëtar i " "
Alfred Karamuço	Anëtar i " "
Kristofor Peçi	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 10.11.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me

dyer të hapura çështjen me nr.38 Akti që i përket:

KËRKUES: KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE ISH-PRONARË TË PREFEKTURËS SË QARKUT TIRANË, përfaqësuar nga avokat Arqile Nini, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. ALEKSANDËR ÇURÇIA,

2. AGETINA, SEVERIN E MARIJE ÇURÇIA, në mungesë.

3. AVDULLA GURABARDHI, përfaqësuar nga avokate Vitore Tusha, me prokurë.

4. FATMIR, LEONARD, ZYRA, SUZANA, MIMOZA, SABRIJE, SHABAN E PETRIT GURABARDHI, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.14, datë 5.4.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.126, datë 20.01.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 133 e 134 të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme:

- Gjykata e Lartë ka thirrur në gjykim si palë, Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë, kur ky i fundit kishte pushuar së ekzistuari si person juridik dhe kompetencat e tij i kishin kaluar komisionit të Prefekturës së Qarkut.

- Gjykatat u kanë lënë barrën e provës paditësve dhe jo të paditurve, megjithëse paditësit kanë një truall dhe një akt publik që vërtetojnë se shënimet në regjistrat e pasurisë së palujtshme janë të sakta.

- Gjykata duhet të caktonte një grup tjetër ekspertësh përderisa nuk ishte sqaruar pozicioni gjeografik i pronës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e palës kërkuese, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë, me vendimin nr.772, datë 6.10.1994, u ka njohur dhe u ka kthyer subjekteve të interesuara "Gurabardhi" një sipërfaqe trualli prej 123 m^2, në bazë të nenit 4 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Këtë vendim e kanë kundërshtuar në gjykatë trashëgimtarët e Mikel Çurçisë, duke pretenduar se janë ata pronarë të truallit.

Gjykata e Rrethit Tiranë ka thirrur si të paditur në gjykim Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë dhe me vendimin nr.3606, datë 22.7.1997 ka vendosur rrëzimin e padisë së subjekteve të interesuara, trashëgimtarëve të Mikel Çurçisë, për anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.14, datë 5.4.2000.

Pas përfundimit të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, ka dalë vendimi nr.138, datë 22.3.2001 i Këshillit të Ministrave, me të cilin është ndryshuar vendimi i mëparshëm nr.301, datë 14.6.1993 dhe kompetencat që kishte Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë i kaluan Komisionit të Prefekturës së Qarkut. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.126, datë 20.1.2003, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Në çështjen në gjykim është vënë në diskutim legjitimimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Prefekturës së Qarkut për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Sipas nenit 134 të Kushtetutës, legjitimi i individit kushtëzohet nga interesi i tij, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore; ndërsa sipas nenit 16/2 të Kushtetutës edhe personat juridikë mund të jenë bartës të të drejtave e lirive themelore, por vetëm për aq sa këto të drejta e liri përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e vetë të drejtave e lirive themelore.

Personat juridikë të së drejtës private janë përfitues të këtyre të drejtave e lirive dhe si të tillë mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pretendime për proces jo të rregullt, sipas nenit 42 e 131/f të Kushtetutës. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe partitë politike e organizatat e tjera që kanë qëllim të mbrojnë liri e të drejta të veçanta të individëve, si p.sh. të drejtën e zgjedhjes e lirinë e besimit.

Çështja ndryshon përsa i përket personave juridikë publikë. Ata ushtrojnë funksione shtetërore e marrin vendime pa qenë bartës të të drejtave e lirive themelore. Rregullimet e aktet që nxjerrin këto organe nuk mund të bëhen objekt i të drejtave themelore nga vetë ata, sepse mungon lidhja e tyre me qenien njerëzore. Qëllimi themelor i të drejtave e lirive është mbrojtja e sferës private të individit nga shteti, prandaj organizmat e vetë shtetit nuk mund të bëhen subjekte të të drejtave dhe lirive themelore gjatë kryerjes së detyrave shtetërore. Si përjashtim, personat juridikë publikë mund ta venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur ata marrin pjesë në qarkullimin civil e cenohen njëlloj si të ishin qytetarë të thjeshtë, si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtpërdrejt me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore, që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre. Në rastin e fundit do të trajtoheshin si individë që venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të nenit 134/1 "g" në lidhje me nenin 16/2 të Kushtetutës edhe organet e pushtetit lokal, universitetet dhe stacionet radiotelevizive.

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Prefekturës së Qarkut Tiranë, në çështjen në shqyrtim, kundërshton gjykimin e Gjykatës së Lartë për një vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave të Bashkisë, pra për një çështje që nuk ka të bëjë me të drejtën subjektive të vetë komisionit, por me veprimtarinë vendimmarrëse të tij për kthimin e pronave ish-pronarëve. Duke u nisur nga kjo dhe nga fakti që ai nuk vërtetoi t'i jetë prekur ndonjë interes tjetër juridik, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, kërkesa duhet të rrëzohet për mungesë legjitimimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM
Nr. 20, datë 22. 12. 2003

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 20.09.2003 "MBI PROCEDURËN E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE ADMINISTRIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT NGA

KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT", NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN NR.18, DATË 11.10.2003

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29/1, të nenit 109 të ligjit nr 9087, datë 19.6.2003 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

Neni 1

Pas nenit 9 të udhëzimit nr. 9, datë 20.9.2003 "Mbi procedurën e numërimit të votave dhe administrimin e fletëve të votimit nga komisioni i qendrës së votimit", ndryshuar me udhëzimin nr. 18, datë 11.10.2003, shtohet neni 9/a me përmbajtje si vijon:

"Komisioni i qendrës së votimit do t'i konsiderojë fletët e votimit si të pavlefshme kur vota në të paktën njërën nga pjesët e fletës së votimit është konsideruar e pavlefshme. Fletët e votimit të pavlefshme administrohen nga komisioni i qendrës së votimit, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.9, datë 20.12.2003.".

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KËRKESË

Shtetasi Bajram Tafa, lindur më 7.8.1923, banues në Luz i Vogël kërkon shpalljen të vdekur të djalit të tij, Faik Tafa.

KËRKUES
Bajram Tafa

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 31.12.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Kristalina KH
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë